

UDHËZIM
Nr. 5, datë 25.2.2013

PËR STANDARDET E PËRGJITHSHME TË MËSUESIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të pikës 11 të nenit 6 të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. T’u dërgohen “Standardet e përgjithshme të mësuesit”:
 - a) DAR-ve dhe ZA-ve,
 - b) IZHA-s,
 - c) Inspektoratit Shtetëror Arsimor.
 2. DAR/ZA-të t’u dërgojnë këto standarde institucioneve arsimore nën juridiksionin e tyre.
 3. Drejtorët e institucioneve arsimore t’ua vënë mësuesve në dispozicion këto standarde.
 4. MASH dhe IZHA t’i publikojnë këto standarde në faqet e tyre përkatëse të internetit.
 5. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen sekretari i përgjithshëm dhe Drejtoria e Edukimit Parauniversitar.
- Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj